

# STATUTI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

**“Smart Pro Solutions” Sh.p.k.**

Në bazë të Ligjeve në Republikën e Shqipërisë :

- Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”.
- Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Me vullnetin tim të lirë deklaroj se kam përpiluar si më poshtë vijon Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, të emërtuar “Smart Pro Solutions” Shpk.

Themeluesi dhe ortaku i vetëm:

Elio Harizi, me kombësi e shtetësi shqiptare, lindur më 25.07.2003 në Tiranë dhe me banim: Rruga “Hasan Sufa”, Nd.24, H.1, Apt.5, Nj.Administrative 1, 1004, Tiranë, identifikuar nëpërmjet dokumentit Letërnjoftim Elektronik Nr.035872634, datë 18.02.2020 dhe Nr Personal (NID) K30725061C, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

## **KAPITULLI I:THEMELIMI, EMRI, FORMA, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

### **NENI 1**

#### **THEMELIMI, EMRI DHE FORMA**

Sot, më datë 07.11.2023 themelohet Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin “SMART PRO SOLUTIONS” Shpk.

Shoqëria “SMART PRO SOLUTIONS” Shpk është krijuar në formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar dhe rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti i përpiluar posaçërisht.

Shoqëria vepron sipas ligjeve shqiptare në fuqi dhe ligjeve të tjera që do të emetohen gjatë periudhës së aktivitetit të shoqërisë.

Akti i Themelimit dhe Statuti janë konform normativave shqiptare në mënyrë të pashmangshme dhe janë pjesë përbërëse e ligjit shqiptar.

Shoqëria merr personalitet juridik shqiptar nga dita e regjistrimit të saj në zyrën e QKB Tiranë.

Shoqëria, për aktivitetin që do të ushtrojë, do të përdorë emërtimin: “Smart Pro Solutions” Shpk.

### **NENI 2**

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar emërtuar “SMART PRO SOLUTIONS” Shpk ka për objekt të veprimtarisë së saj:

2.1. Ofrimin e shërbimeve të asistencës për persona fizikë e juridikë / shoqëri vendas/e dhe të huaj/a të cilët/at dëshirojnë të përdorin burime të jashtme (outsourcing) për qëllime të aktivitetit dhe proceseve të punës së tyre (BPO – Business Process Outsourcing), studime tregu e studime të ndryshme me karakter informues për klientët apo partnerët e Shoqërisë në të gjitha fushat, konsulencë strategjike, marketingu, financiare dhe kontabël, si dhe aktivitetet e ndërmjetësimit konform legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2.2. Shoqëria mund të kryejë në Shqipëri dhe jashtë shtetit të gjitha operacionet (veprimet) komerciale, industriale dhe financiare, të tundshme dhe të patundshme të shoqërive të tjera apo kompanive me objekt veprimtarie analog administrativ për arritjen e objektivit të Shoqërisë, mund të marrë përsipër dhe të japë delegime dhe pjesëmarrje të një domosdoshmërie e rëndësie të veçantë nga organi administrativ për arritjen e objektivit të Shoqërisë në shoqëri të tjera apo kompani me objekt veprimtarie analog, të lidhur me të në mënyrë direkte apo indirekte.

2.3. Krijimin, administrimin dhe përhapjen e bazave të të dhënave në sisteme të kompiuterizuara të administruara nga Shoqëria.

2.4. Krijimin, çeljen dhe administrimin e call center për ofrimin e shërbimit ndaj klientit për të gjitha llojet e shërbimeve të mundshme në të gjithë sektorët e fushat ku mund të operohet, shërbime të lidhura me financa dhe / apo kontabilitetin, IT support, shitje produktesh, kontratash e shërbimesh të ndryshme për llogari të Shoqërisë apo të të tretëve, me telefon, online, apo me çdo mënyrë tjetër kontakti të parashikuar.

Shoqëria për ofrimin e shërbimeve të sipër përmendura, në bazë të normativave në fuqi, mund të shfrytëzojë edhe palë të treta.

Gjithashtu Shoqëria, në lidhje me sektorët e sipër përmendur, mund të kryejë aktivitete ndërmjetësie dhe të marrë mandate nga agjensitë dhe / apo përfaqësitë me apo pa depozitë.

Në objektin e veprimtarisë përfshihet pjesëmarrja në shoqëri të çdo lloji, partneritete, ente, shoqata dhe subjekte të çfarëdolloj natyre me objektiv të ngjashëm apo analog me atë të Shoqërisë.

### **NENI 3**

#### **SELIA**

Selia e Shoqërisë është vendosur në: ***Rruga "Myrtezim Këlliçi", Pallat, Apt 28, Tiranë.*** Këshilli Administrativ mund të krijojë, modifikojë apo anultojë seli sekondare, agjensi dhe përfaqësi kudo që e quan të nevojshme, madje edhe jashtë shtetit.

Qendra fiskale e ortakëve, përsa u përket raporteve të tyre me Shoqërinë, është selia e Shoqërisë.

Adresa e Shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është: ***sps07.albania@gmail.com***

### **NENI 4**

#### **KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pacaktuar dhe mund të zgjidhet përpara kohe me miratim të Asamblesë së Jashtëzakonshme.

## **KAPITULLI II: KAPITALI I SHOQËRISË**

### **NENI 5 KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali Themeltar është 10.000 (Dhjetëdmijë) Lekë dhe është ndarë në 1 (një) kuotë me vlerë 10.000 (Dhjetëdmijë) Lekë, me numër serie 1 (Një).

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Themeluesi dhe ortaku i vetëm Elio HARIZI: zotërues i 1 (një) kuote që përbën 100% (njëqind përqind) të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Të ardhurat neto të Shoqërisë i takojnë ortakut të vetëm.

### **NENI 6 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të Kapitalit Themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### **NENI 7 TRANSFERIMI I KAPITALIT**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e Kapitalit Themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në Statut. Pjesët e Kapitalit Themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KAPITULLI III: ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

#### **NENI 8 ORGANI VENDIMMARRËS**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas mënyrave të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë lidhur me çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## **NENI 9**

### **MËNYRA E THIRRJES SË MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## **NENI 10**

### **KUORUMI**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **NENI 11**

### **MARRJA E VENDIMEVE**

Asambleja e përgjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  (tri të katërtat) e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;  
Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

## **NENI 12 PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga Shoqëria;
  - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku të cilin përfaqëson.

## **NENI 13 ADMINISTRIMI**

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të Shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i Parë i Shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:  
(emri, mbiemri, adresa):

Elio HARIZI  
*Rruga "Hasan Sufa", Nd.24, H.1, Apt.5, Nj.a.1, 1004, Tiranë*

## **NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:  
a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

- b) përfaqësojnë Shoqërinë tregtare;
  - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
  - ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
  - dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
  - e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë tregtare;
  - ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër, aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% (pesë përqind) të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% (pesë përqind) të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht Shoqërinë.
- Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.
- Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me Shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **NENI 15**

### **PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj Shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm Shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.



Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare”, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të Shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet Shoqërisë;
- ç) lejon që Shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që Shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar Shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## **KAPITULLI IV: VITI FINANCIAR – EKSPERTËT**

### **NENI 16 VITI FINANCIAR**

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

### **NENI 17 EKSPERTËT**

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko – tregtare të Shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar ortakët. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **KAPITULLI V: PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

### **NENI 18 PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

Shpërndarja ose prishja e Shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të Shoqërisë, duke caktuar 1 (një) apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë: “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **NENI 19**

#### **RIORGANIZIMI I SHOQËRISË: BASHKIMI – NDARJA**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

#### **NENI 20**

#### **BAZA LIGJORE**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 21**

#### **MOSMARRËVESHJET**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky Statut u hartua në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe për t'iu shpërndarë organeve kompetente dhe 1 (një) kopje do të ruhet në dokumentacionin bazë të Shoqërisë “SMART PRO SOLUTIONS” Shpk.

### ***ORTAKU DHE THEMELUESI I VETËM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “SMART PRO SOLUTIONS”***

Elio HARIZI

*(emër, mbiemër, nënshkrimi)*